



# KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

*Raporti vjetor i punës për vitin 2014*

*drejtuar*

*Kuvendit të Republikës së Kosovës*

## Contents

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së.....	6
KPM tani ka në përbërje të vet pesë (5) anëtarë: .....	7
Historiku i nominimeve-2014.....	7
Takimet me përfaqësues të Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale.....	10
Bashkëpunimi me Autoritetin e Republikës së Shqipërisë.....	10
Bashkëpunimi me Autoritetin e Republikës së Turqisë.....	11
Bashkëpunimi me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE) .....	11
Bashkëpunimi me OSBE-në .....	11
Bashkëpunimi me Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK).....	12
Bashkëpunimi Ndërkombëtar .....	12
ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE .....	13
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale .....	15
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren 2013/03 për Komunikime Komerciale Audio-vizuale.....	15
Televizioni Publik i Kosovës – RTK1 .....	15
Televizionet nacionale: TV21 dhe KTV .....	16
Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të.....	16
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit .....	16
Monitorimi i Pajtushmërisë së Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së .....	16
Monitorimi i Zgjedhjeve të Përgjithshme 2014.....	17
Pajtushmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale.....	17
Monitorimi i Operatorëve Kabllorë .....	18
Vizitat/ Inspektimet.....	18
Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës.....	18
Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:.....	19
Numri i Operatorëve Kabllorë të licencuar:.....	19
Ofruesit e Shërbimeve Programore (OSHP).....	19
Shqyrtimi i kërkesave .....	19
Në përgjithësi, gjatë vitit 2014 janë marrë këto vendime për licencim: .....	20
Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2015, janë gjithsej 2 raste: .....	20

Rastet për transmetim ilegal-Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, e Ligjit të KPM-së .....	20
Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KPM -2013/03..	21
Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01 .....	21
Rastet për shkelje të Rregullores për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02 .....	21
Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës .....	21
Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM-2010/02.....	22
Rastet e Shkeljes së Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM- 2010/01...	22
Rastet për shkeljen e Rregullores për Distribuim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04.....	22
Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së neni 28-Mos sjellja e raportit vjetor .....	22
Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së, Neni 22, paragrafi 3.1 (përfshirja e pronarëve të medie në aktivitete politike) .....	23
Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme kreut VIII, Nr. 03/L-073, Neni 49, paragrafi 6 .....	23
Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2014 .....	23
Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....	24
Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....	24
Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini).....	25
Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal .....	25
Rastet për interferencë .....	26
Subjektet transmetuese që kanë ndërperë transmetimin .....	26
Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR. ....	26
Gjetja e frekuencave të lira .....	26
Kërkesa për ndryshimin të lokacionit të transmetimit .....	26
Ndryshimet e frekuencave (kanaleve TV) të subjekteve transmetuese: .....	27
Ngritja e kapaciteteve .....	27
Buxheti.....	28
Seancat e BA dhe Vendimet .....	29
Rekomandimet/sfidat e institucionit (problemet me buxhetin, rritja e stafit, ndryshimi i ligjit) ..	31
Problemet me buxhetin .....	31
Nevoja për punëtorë të rinj .....	31

Miratimi i Draft Strategjisë dhe Ligjit për Digjitalizim.....	31
Kolezioni në mes të Ligjit të KPM-së dhe ARKEP-it .....	31
Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) .....	32

Shtojca I	Organogrami
Shtojca II	Monitorimi i shërbyesve medial audio-vizuel gjatë fushatës për Zgjedhje Parlamentare 2014
Shtojca III	Paraqitja Tabelare E Rasteve Ligjore
Shtojca IVa	Raporti Vjetor Financiar
Shtojca IVb	Raporti Vjetor Financiar

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Raporti për vitin 2014, janar-dhjetor, pasqyron punën njëvjeçare të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM). Raporti është i ndarë në kapituj ku është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësi të KPM-së.

Raporti përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe kohore për të cilën raportohet, amandamentimi/miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i KPM-së me të licencuarit, bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi me rregullatorët në rajon e më gjerë. Po ashtu në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele vizuele të licencuara në KPM, me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, statistikën e numrit të të licencuarve, rastet ligjore të proceduara, shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës, raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak.

Për të realizuar objektivat institucionale të caktuara më parë, KPM ka vazhduar punën në finalizim të Strategjisë për kalim nga sistemi analog tokësor në atë digjital të transmetimeve. KPM ka respektuar procedurat ligjore për konsultim publik dhe ka përfshirë të gjithë aktet relevant në hartimin e Strategjisë. Në draftin e Strategjisë për Digjitalizim, KPM ka ofruar propozime që fuqizojnë interesin maksimal, në radhë të parë të Kosovës, interesin e akterëve të industrisë mediale dhe zhvillimin e pluralizmit medial. Drafti i Strategjisë ofron zgjidhje për zhvillimin e sektorit medial në Republikën e Kosovës, duke i ofruar qytetarëve të saj shërbime cilësore mediale audio-vizuele, si dhe duke qenë në hap me zhvillimet e fundit teknologjike në këtë fushë. Gjithashtu, drafti i Strategjisë parasheh zhvillim edhe tek të licencuarit aktual, të cilët do të kenë mundësi të arrijnë synimet e tyre për të qenë sa më profesional dhe konkurrent, ku nëpërmjet standardeve programore të përcaktuara në këtë draft, ata do të kenë hapësirë dhe fushëveprim më të madh në tregun medial të Republikës së Kosovës, por edhe më gjerë. Me Ligjin 04/L-44 për KPM-në, procesi i kalimit në transmetim digjital rregullohet me ligj të veçantë, i cili duhet të bazohet në Strategjinë e KPM-së për Digjitalizim.

Objektivat e KPM-së për vitin e ardhshëm janë përcjellja e procesit të digjitalizimit në tërë kompleksitetin e vet, zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, avancimi dhe harmonizimi i akteve nënligjore me rregullativen evropiane si dhe zhvillimi i politikës së transmetimit.

Për vitin 2015, prioritet parësor i KPM-së është implementimi i Strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës, krijimi i bazës ligjore sekondare për zbatueshmërinë e Strategjisë si dhe ndërtimi i rrjetit për transmetim televiziv tokësor digjital SFN- allotmenti Kosova.

Buxheti i pamjaftueshëm, si pasojë e shkurtimeve buxhetore dhe pamundësia për të pasur numër të mjaftueshëm të stafit, karshi numrit të madh të të licencuarve dhe obligimeve e detyrave të reja që do të dalin nga të licencuarit e rinj në epokën digjitale, përbëjnë një sfidë të vazhdueshme për përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore të institucionit.

**Mars 2015**  
**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**

## **KORNIZA LIGJORE**

KPM është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe ka hyrë në fuqi me 20 prill 2012. Në bazë të këtij ligji, përkatësisht Nenit 3, KPM-ja është i vetmi autoritet rregullativ për fushën audio-vizuale, i cili harton dhe miraton politikën e transmetimit si dhe të gjitha aktet nënligjore rregullative për fushën audio-vizuale.

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2.8 KPM-ja “*i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.

## **PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT**

KPM është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Misioni i KPM-së është:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare.
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuale
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuale

## **ORGANIZIMI INSTITUCIONAL**

### **Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së**

Sipas Ligjit të Nr. 04/L-44, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11 pika 2.1. të Ligjit për KPM, i cili përcakton: “brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”.

## **KPM tani ka në përbërje të vet pesë (5) anëtarë:**

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Adnan	MEROVCI	Kryetar	më 19 mars 2014	mandat 4 (katër) vjeçar
Driton	QERIQI	Nënkryetar	më 19 mars 2014	mandat 3 (tre) vjeçar
Anita	MORINA-SARAÇI	Anëtare	më 19 mars 2014	mandat 2 (dy) vjeçar
Abit	HOXHA	Anëtar	më 14 prill 2014	mandat 2 (dy) vjeçar
Xhemajl	KRASNIQI	Anëtar	më 30 gusht 2012	mandat 4 (katër) vjeçar

Mandati i anëtarëve të KPM-së është i përcaktuar me short i përcaktuar me nenin 13, paragrafi 2, i Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në.

### **Historiku i nominimeve-2014**

KPM-ja ka filluar vitin 2014 me mungesë të pesë anëtarëve të organit vendimmarrës, gjë që ka pamundësuar funksionimin e KPM-së në aspektin e vendimmarrjes.

Për të plotësuar vendet e anëtarëve të KPM-së, Zyra Ekzekutive bazuar në nenin 11 të Ligjit për KPM-në Nr. 04/L-44, ka bërë ftesë publike për nominime për pesë (5) anëtarë të KPM-së, tre (3) nga radhët e komunitetit shumicë shqiptare dhe dy (2) nga radhët e komuniteteve jo shqiptare në Republikën e Kosovës. Afati për nominime ishte prej 10 deri më 31 janar 2014. Në zyrën e KPM-se kishin arritur gjithsejtë gjashtëdhjetë (60) nominime. Zyra Ekzekutive e KPM-së në aspektin teknik ka përgatitur, pakon e dokumentacioneve të të gjithë kandidatëve të cilët më 28 shkurt 2014, i ka përcjell tek Komision Ad-hoc për procedurë të mëtutjeshme.

Më 11 shkurt 2014, si pasojë e dorëheqjes së një anëtareje të Komisionit të Pavarur të Mediave, Zyra Ekzekutive përsëri bëri ftesë publike për nominime të reja për një anëtar të KPM-së. Prej 13 deri më 27 shkurt 2014 sa ishte afati për nominime, KPM pranoi gjithsejtë gjashtë (6) nominime. Sipas procedurës, më 14 shkurt 2014 të gjitha dokumentacionet e kandidatëve të nominuar u përcollën në Kuvend.

Në seancën e mbajtur më 19 mars 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave nga pese anëtarë sa do të duhej të zgjedhte, Kuvendi zgjodhi vetëm 3 anëtarë të KPM-së.

Pasi që dy anëtarë nuk arritën të marrin votat e mjaftueshme për tu zgjedhur anëtarë të KPM-së, Kuvendi kërkoi nga KPM që të përsëriste ftesën publike për nominime nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës. Afati për nominime ishte nga 25 mars 2014 deri më 8 prill 2014. Në KPM arritën gjithsejtë pesëmbëdhjetë 15 nominime. E njëjta procedure u zhvillua edhe me këto nominime ku me 10 prill 2014, i gjithë dokumentacioni i kandidatëve të nominuar u përcoll në Kuvend. Ndërkaq më 14 prill 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjodhi edhe një anëtarë të KPM-së.

Emërimi i anëtarit të pestë të KPM-së mundësoi edhe takimin e Komisionit, ku më 15 prill 2014 Komisioni zgjodhi kryetar të KPM-së z. Adnan MEROVCI.

Komisioni i Pavarur i Mediave funksionon ka përfunduar vitin 2014 në përbërje të pesë (5) anëtarëve nga shtatë (7) sa do të duhet t'i ketë.

KPM pret nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që në 2015 të emërojë edhe dy anëtarë të KPM-së, nga radhët e komuniteteve jo shqiptare në Republikën e Kosovës, për të kompletuar organin vendimmarrës të këtij institucioni.

## **AKTIVITETET PËR PERIUHDHËN RAPORTUESE**

Gjatë vitit 2014, në bazë të obligimeve ligjore, KPM-ja ka mbajtur 20 mbledhje të rregullta në të cilat ka shqyrtuar dhe marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit të KPM-së, si dhe akteve nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve mediale audio-vizuale.

Gjatë vitit 2014 KPM ka marrë këto vendime:

- 4 vendime për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore (OSHP);
- 2 vendime për licencimin e Operatorëve Kabllorë (OK);
- 3 vendime për ndryshimin e emrit;
- 4 vendime për ndryshimin e pronësisë;
- 5 vendim për revokimin e licencës – OSHP;
- 1 vendime për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit.
- 4 vendime për refuzim të kërkesave si të pa bazuara/ pa kompletuara.
- 4 vendime për ndërprerje të licencës së transmetimit-radio
- 1 vendime për ndërprerje të licencës së transmetimit-TV
- 1 vendim për suspendim të licencës 3 muaj -TV
- 2 vendime për ndërprerje të transmetimit ilegal-radio
- Vendim për 18 raste të licencimit për ndryshim/korrigjim të certifikatave të licencës

## **PUNA E KPM-së LIDHUR ME FINALIZIMIN E DRAFT STRATEGJISË PËR DIGJITALIZIM**

Sipas Ligjit për KPM-në, Nenit 3, kompetencë e KPM-së është përgatitja e strategjisë për kalim në transmetim Digjital në Republikën e Kosovës, për t'u miratuar pastaj nga Qeveria.

Në kuadër të aktiviteteve për finalizimin e Strategjisë për kalim nga sistemi analog tokësor i transmetimeve në atë digjital, KPM më 22 dhjetor 2014 ka realizuar tryezën me temën: “STRATEGJIA E DIGJITALIZIMIT PARA DISKUTIMIT PUBLIK”, në të cilën KPM ka pasqyruar punën dhe hapat e KPM-së në përcaktimet e rregullativës ligjore, teknike, programore,



ekonomiko-shoqërore, procesit të implementimit të Televizionit Tokësor Digjital (DTT), informimit publik si dhe paraqitjen e planit të veprimit për zbatim të Strategjisë.

Më 24 dhjetor 2014, KPM ka mbajtur mbledhje të rregullt në të cilën ka miratuar për konsultim publik tekstin e ndryshuar dhe të plotësuar të Draft Strategjisë për Kalim në Transmetim Digjital Tokësor në Republikën e Kosovës.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, më 26 dhjetor 2014, KPM ka publikuar Draftin e Strategjisë për Kalim në Transmetim Digjital Tokësor në Republikën e Kosovës dhe u ka vënë në dispozicion për konsultim publik dhe komente me shkrim përfaqësuese të shërbimeve mediale audio-vizuale të licencuara nga KPM, institucioneve relevante të Republikës së Kosovës, OJQ-ve dhe palëve tjera të interesuara. Afati për dërgimin e komenteve me shkrim është caktuar për periudhën 26 dhjetor 2014 deri më 23 janar 2015.

Në draftin e Strategjisë për Digjitalizim, KPM ka ofruar propozime që fuqizojnë interesin maksimal, në radhë të parë të Kosovës, interesin e akterëve të industrisë mediale dhe zhvillimin e pluralizmit medial.

Draft i Strategjisë ofron zgjidhje për zhvillimin e sektorit medial në Republikën e Kosovës, duke i ofruar qytetarëve të saj shërbime cilësore mediale audio-vizuale, si dhe duke qenë në hap me zhvillimet e fundit teknologjike në këtë fushë.

Gjithashtu, draft i Strategjisë parasheh zhvillim edhe tek të licencuarit aktual, të cilët do të kenë mundësi të arrijnë synimet e tyre për të qenë sa më profesional dhe konkurrent, ku nëpërmjet standardeve programore të përcaktuara në këtë draft, ata do të kenë hapësirë dhe fushëveprim më të madh në tregun medial të Republikës së Kosovës, por edhe më gjerë.

## **MIRATIMI I AKTEVE NËNLIGJORE QË RREGULLOJNË FUSHËN E SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO-VIZUALE**

Pas përfundimit të procedurave të parapara me ligj për nxjerrjen e legjislacionit sekondar (neni 8 të Ligjit për KPM-në 04/L-44), duke u vënë kështu në dispozicion përfaqësuesve të shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesuara për të ofruar komente me shkrim lidhur me këto akte nënligjore, KPM ka amandamentuar/miratuar këto akte nënligjore:

- Më 23 maj 2014, KPM ka miratuar *Rregulloren e Punës së Komisionit të Pavarur të Mediave 2014/01*.
- Më 1 dhjetor 2014 ka miratuar *Rregulloren KPM 2014/02 për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM-së*, e cila është nënshkruar me 5 dhjetor 2014 dhe po të njëjtën ditë ka hyrë në fuqi.
- Më 29 dhjetor 2014, KPM ka miratuar *Rregulloren e re KPM 2014/03 për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë*. Rregullorja ka hyrë në fuqi më 30 dhjetor 2014.
- Gjithashtu në proces të amandamentimit është edhe Rregullorja KKPM 2007/04 për Operatorët Kabllor.

# **BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE**

KPM ka vazhduar bashkëpunimin me institucione vendore duke marrë pjesë aktive në organizimin e aktiviteteve si tryeza e konferenca. Ka marrë pjesë në të tilla si ajo e organizuar nga Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës për komunikim sa me të mirë në përmbushjen e obligimeve ligjore të ndërsjella, pastaj pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare liria e informimit, qasja në dokumente publike dhe mbrojtja e të dhënave personale, e organizuar nga Zyra për informim e Zyrës së Kryeministrit etj.

## **Takimet me përfaqësues të Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale**

Pas konstituimit me përbërje të re, me iniciativë të KPM-së, prej 23 prill e deri më 22 maj 2014, KPM ka mbajtur takime me përfaqësues të shërbimeve mediale audio-vizuale.

Qëllimi i takimeve ishte përmbushja e detyrave dhe obligimeve ligjore të KPM-së si rregullator i transmetimit në njërën anë dhe detyrave dhe obligimeve të shërbyesve medial audio vizual në anën tjetër, çështjet me prioritet për KPM-në (ndryshimi/plotësimi i akteve nënligjore dhe procesi i digjitalizimit.)

Fokusi kryesor i këtyre takimeve ishte procesi i digjitalizimit, respektivisht rolit kyç i KPM-së si autorë dhe përgjegjëse për përgatitjen e strategjisë, e cila pastaj duhet të përcillet edhe me Ligjin për Digjitalizim. Po ashtu, si çështje brengosëse janë shqyrtuar afatet kohore të mbetura për kalim nga transmetimit tokësor analog në atë digjital tokësor mirëpo, që kjo nuk duhet të shërbejë për ndonjë veprim të ngutshëm për këtë proces kaq të rëndësishëm.

Në këto takime theks i veçantë i është vënë problemit që ndërlidhet edhe me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) dhe mos anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Është konkluduar që Kosovës duhet t'i sigurohen resurse frekuencore të mjaftueshme që i përgjigjen nevojave të vendit.

Theks i veçantë në këto takime, i është vënë mënyrës së kategorizimit të subjekteve transmetuese si dhe trajtim të barabartë të tyre sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Përfaqësuesit e shërbyesve medial audio-vizual në këto takime kanë shprehur brengat e tyre lidhur me vështirësitë financiare me të cilat ballafaqohet kjo industri.

## **Bashkëpunimi me Autoritetin e Republikës së Shqipërisë**

KPM ka një bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audio-vizive të Republikës së Shqipërisë (AMA), në fushën e rregullimit të transmetimeve audio vizuale.

Në kuadër të bashkëpunimit reciprok të dy vendeve, një delegacion i AMA-së më 2 dhjetor 2014, ka vizituar KPM-në. Në këtë takim zyrtarët më të lartë të dy autoriteteve rregullative të sferës audio-vizuale të të dy vendeve kanë shqyrtuar hapësirat dhe mundësitë e ngritjes së bashkëpunimit të më tutjeshëj e sidomos rreth procesit të digjitalizimit tokësor të mediave audio-vizuale.

Duke qenë se Shqipëria është anëtare e ITU-së (Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit), kërkesë e vazhdueshme e KPM-së për autoritetin e Republikës së Shqipërisë është adresimi i sfidave të trashëguara të Kosovës, lidhur me planin frekuencor digjital tokësor dhe ndihma e tyre deri në anëtarësimin e Kosovës në këtë mekanizëm ndërkombëtar.

Konkretizimi i bashkëpunimit reciprok në mes KPM-së dhe AMA-së shumë shpejtë do të bëhet me nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi, e cila aktualisht është në nivel drafti.

### **Bashkëpunimi me Autoritetin e Republikës së Turqisë**

Një bashkëpunim tillë si me autoritetin e Republikës së Shqipërisë, KPM ka edhe me Këshillin Suprem të Radios dhe Televizionit të Republikës së Turqisë (RTÜK).

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në mes të dy rregullatorëve, në fushën e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale, e në veçanti në teknologjitë e reja të transmetimeve tokësore digjitale, më 16 maj 2014 në Prishtinë, KPM ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me RTÜK.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes, dy autoritetet janë zotuar në shkëmbim të përvojave dhe njohurive në lidhje me programet audio dhe audio-vizuale, mbështetjen e nevojshme teknike në lidhje me përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit me qëllim të rritjes së efikasitetit, ofrimin reciprok të informacionit mbi rregullat ligjore etj.

### **Bashkëpunimi me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE)**

Fokus kryesor i bashkëpunimit të KPM-së me Zyrën e Bashkimit Evropian gjatë vitit 2014, ishte në përkrahjen profesionale me ekspertizë në punën e finalizimit të Strategjisë për Digjitalizim. Gjatë përgatitjeve që janë bërë për të finalizuar Draftin e Strategjisë, KPM ka punuar ngushtë edhe me ekspertin e angazhuar përmes Komisionit Evropian për të bërë ndryshimet dhe plotësimet finale të Strategjisë.

Meqë ky vit (2015), do të jetë vit i fillimit të implementimit të Strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësorë, edhe më tutje KPM do të ketë nevojë për sugjerime dhe këshilla profesionale nga ana e Zyrës së BE-së në Kosovë.

### **Bashkëpunimi me OSBE-në**

Në bashkëpunim me OSBE-në Misioni në Kosovë, KPM kanë qenë bashkorganizatore e konferencës ndërkombëtare për digjitalizimin e transmetimit televiziv tokësor me titull: “Digi Dare – Before the Final Sëitchover” (Guximi digjital – Para kalimit final në digjitalizim”). Konferenca është mbajtur në Prishtinë më 11 dhe 12 dhjetor 2014.

Për dy ditë sa ka zgjatur konferenca, përvojën e tyre e kanë paraqitur përfaqësues të agjencioneve rregullative për media audio-vizuale të cilët e kanë përfunduar procesin e kalimit në transmetim digjital si: Italia, Spanja, Kroacia, Sllovenia si dhe atyre të cilës janë në përfundim e sipër si: Mali i zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Shqipëria.

Gjithashtu, gjendjen e transmetuesve publik të BE-së lidhur me digjitalizim e kanë paraqitur përfaqësues të Unionit të Transmetuesve Evropian (EBU) si dhe përfaqësues të vetë

transmetuesve publikë nga: Sllovenia, Kroacia, Vojvodina, Podgorica, Sarajeva dhe Prishtina, ku kanë treguar për vështirësitë dhe sfidat e tyre gjatë digjitalizimit të brendshëm deri tek përcjellja e sinjalit digjital tek shikuesit.

E veçanta e konferencës ishte pjesëmarrja e përfaqësuesit të Unionit Ndërkombëtarë të Telekomunikacionit (ITU) sepse në një mënyrë ishte mundësia e komunikimit të drejtpërdrejtë me ITU. Me këtë rast KPM shfrytëzoi rastin për të përcjellë brengën e Kosovës në ndarjen e frekuencave digjitale.

Konferenca u cilësuan si mundësi e mirë për të kuptuar arritjet dhe sfidat që janë bërë deri më tani në këtë drejtim në vendet e rajonit dhe BE-së, si dhe mundësitë për të përfituar nga këto përvoja.

### **Bashkëpunimi me Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK)**

Më 16 dhjetor 2014, KPM ka mbajtur një tryezë të rrumbullakët me temën “Raportimi i mediave mbi terrorizmin dhe ekstremizmit” të organizuar në bashkëpunim me *KMSHK-në* dhe *AGK-në*, implementuar nga *Fondacioni Thomson*. Në këtë tryezë në mënyrë kritike janë trajtuar praktikatat e mira dhe të dobëta të raportimit të medias ndërkombëtare dhe vendore, kur është fjala për terrorizmin dhe ekstremizmin në përgjithësi.

### **Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

Me përkrahjen e Ambasadës Franceze në Kosovë dhe me asistencën teknike të Komisionit Evropian të ofruar përmes programit TAIEX, KPM ka realizuar vizitë studimore tek Rregullatori i Francës CSA (*Conseil Supérieur de l'Audiovisuel*). Gjatë qëndrimit në Francë, delegacioni i KPM-së ka vizituar edhe Ministrinë e Kulturës dhe Komunikimit si dhe Institutin Audiovizual Kombëtarë INA. Gjatë takimeve me këto tre institucione janë ndarë përvojat në çështjet e rregullimit të transmetimit në epokën digjitale, përmbajtjeve programore dhe metodave të arkivimit të përmbajtjeve programore.

Vizita është bazuar në objektivat dhe planet e KPM-së për të realizuar rishikimin dhe hartimin e një numri të dokumenteve strategjike, akteve nënligjore të cilat janë të nevojshme për zbatimin e ligjit të KPM-së dhe për përgatitjet finale të procesit të transmetimeve digjitale tokësore.

KPM është përfaqësuar edhe në takimin tjetër në nivel ekspertësh për rregullimin e mediave të reja të organizuar nga Zyra e Përfaqësuesit të Lirisë së Mediave të OSBE-së. Takimi është mbajtur në Vjenë më 18 shtator 2014.

Po ashtu, KPM është përfaqësuar edhe në konferencën regjionale të organizuar nga Këshilli i Evropës në të cilën janë trajtuar aspektet rregullatorë rreth pronësisë së mediave, transparencës dhe metodave për parandalimin e koncentrimin të mediave. Takimi është mbajtur në Shkup më 25 dhe 26 shtator 2014.

## ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të aktiviteteve për finalizimin e Strategjisë për kalim nga sistemi analog tokësor i transmetimeve në atë digjital, KPM ka mbajtur dy tryeza:

tryeza me temën “DIGJITALIZIMI NË KOSOVË” e mbajtur më 29 maj 2014 dhe tryeza temën: “STRATEGJIA E DIGJITALIZIMIT PARA DISKUTIMIT PUBLIK” e mbajtur më 23 dhjetor 2014.

Qëllimi i këtyre organizimeve publike ishte ofrimi i mundësisë që të gjitha palët e interesit të shprehin pikëpamjet, komentet, idetë, vlerësimet, kritikën, interesat dhe propozimet e tyre në raport me kalimin në transmetimin tokësorë Digjital.

Në këto tryeza KPM ka pasqyruar punën dhe hapat e saj në përcaktimet e rregullativës ligjore, teknike, asaj programore, ekonomiko-shoqërore, pastaj procesit të implementimit të Televizionit Tokësor Digjital (DTT), informimi publik si dhe paraqitjen e planit të veprimit.

Për të gjitha këto veprime, KPM ka qenë mjaft transparente duke bërë konsultime dhe duke u koordinuar në vazhdimësi me industrinë mediale, institucionet e Republikës së Kosovës, Zyrën e BE-së dhe akterët tjerë relevant në këtë fushë.

## SHPALLJA E FREKUENCAVE TË LIRA PËR RADIO

Në pajtueshmëri me Politikën e Transmetimit në Republikën e Kosovës, neni 9 i Ligjit për KPM-në si dhe në bazë të nenit 21, 22 dhe 23, KPM më 26 nëntor 2014, ka marrë vendim për të shpallur Konkurs Publik, për dhënien e licencave të reja për transmetimin e programeve në radio, në tetë (8) komuna të Republikës së Kosovës:

	Komuna	Kategoria e licencës
1.	Junik	Lokale
2.	Hani i Elezit	Lokale
3.	Mamushë	Lokale
4.	Obiliqi	Lokale
5.	Istog, fshati Osojan	Me fuqi të ultë
6.	Lipjan	Lokale
7.	Graçanicë	Lokale
8.	Mitrovicë	Lokale

Paraprakisht KPM ka bërë një vlerësim rreth nevojës dhe mundësive frekuencore, me theks të veçantë, në ato komuna të Republikës së Kosovës ku ka pasur mungesë të shërbimeve mediale radio me mbulim lokal, si dhe në ato komuna ku është kërkuar që të krijohet mundësi për pluralizëm medial.

Konkursi për aplikime ka qenë i hapur 30 ditë, duke filluar nga data 26 dhjetor 2014 deri më 26 janar 2015. KPM është në proces të vlerësimit të aplikacioneve të arritura lidhur me këtë konkurs.

## **PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE**

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefja Ekzekutive, e cili ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 Kryeshefja Ekzekutive menaxhon:

- me nëpunësit civilë të KPM-së,
- me financat dhe me burimet tjera të financimit,
- ofron këshilla për politikat e KPM-së,
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive si dhe
- bënë koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë 4 departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (*Shtojca I Organogrami*):

- Departamenti i Monitorimit dhe Analizës,
- Departamenti i Licencimit,
- Departamenti Ligjor
- Departamenti për Menaxhim Frekuencor)
- Departamenti i Administratës
- Në kuadër të Zyrës vepron edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe Departamenti i Prokurimit.

### **Burimet njerëzore**

Zyra e KPM nga fillimi i vitit 2014 ka të punësuar gjithsej 31 punëtorë, aq sa edhe është e përcaktuar me ndarje buxhetore nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF).

Gjatë vitit 2014, KPM ka pasur mungese të tre nëpunësve (për arsye lehonie) me ç'rast është ndier mungesa e tyre. Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 12 Kategoritë e të punësuarve në shërbimin civil, pika 1.2 nuk e mundëson zëvendësim për periudhën gjatë pushimit të lehonisë.

Për këtë qëllim KPM më 20 qershor 2014, KPM i është drejtuar Zyrës së Departamentit të Administratës për Shërbimin Civil (DASHC) me qëllim të mundësimit dhe aprovimit të kërkesës për rekrutim të nëpunësve të karrierës, me qëllim të kryerjes së detyrave dhe obligimeve që parashihen me Ligjin e KPM-së.

Nga zyra e DASHC nuk kemi pranuar asnjë përgjigje me shkrim përveç asaj gojore nga Zyra e sistemit të pagave se nuk është e mundur të futet në sistem të pagave një punëtor i ri përderisa është i plotësuar numri i punëtorëve, mund të futet në sistem vetëm kur lirohet pozita me zero (0) pagë që do të thotë mbas 6 muajve të pushimit të lehonisë.

## **DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE (DMA)**

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave (DMA), gjatë vitit 2014, ka vlerësuar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me të gjitha rregulloret e KPM-së si dhe Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, ndërsa gjatë fushatës për Zgjedhjet e Përgjithshme 2014, ka vlerësuar pajtueshmërinë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 në Republikën e Kosovës.

Realizimi i aktiviteteve të sipërsënuara dhe rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të KPM-së kanë mbështetur shumë veprime të mëtutjeshme.

### **Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuele**

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuale me këtë rregullore, janë monitoruar shërbimet mediale audio-vizuele me mbulim nacional, regjional e lokal si dhe ofruesit e shërbimeve programore.

Gjetjet nga ky monitorim kanë dëshmuar se numri i shërbimeve mediale audio-vizuele të gjetura në shkelje të kësaj rregulloreje është dukshëm më i vogël, krahasuar me monitorimet nga vitet e kaluara.

Shkeljet e neneve 3 dhe 6 të kësaj rregulloreje janë shkeljet më të shpeshta të identifikuar gjatë monitorimit dhe kanë të bëjnë me kufizimet dhe obligimet e përgjithshme, kategorizimin e programeve dhe kohën e transmetimit të tyre.

Është karakteristike të përmendet se shumica e shkeljeve janë bërë me rastin e reprizimit të programeve të natës, veçmas serialeve, ndërsa është vërejtur edhe tendenca që shërbimet mediale audio-vizuale t'i kategorizojnë përmbajtjet programore në kategori më të ulëta në mënyrë që ato t'i transmetojnë në orët më të hershme të mbrëmjes.

### **Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren 2013/03 për Komunikime Komerciale Audio-vizuale**

Në fokus të monitorimeve për pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuele ishin: sasia e reklamave të transmetuara brenda një ore program, vendosja e produkteve, sponsorimet, teleshopingu, reklamimi me ekran të ndarë si dhe dispozita tjera të kësaj rregulloreje.

#### **Televizioni Publik i Kosovës – RTK1**

Përderisa Rregullorja për Komunikime Komerciale Audio-vizuale u lejon shërbyesve medial audio-vizuel komercial që brenda një ore të transmetojnë 12 minuta komunikime komerciale, sipas Ligjit për RTK-në, Televizioni Publik mund të emitojë komunikime komerciale audio-vizuele deri në dhjetë për qind (10%) të vëllimit të tërësishëm programor.

Nga monitorimet për vlerësimin e pajtueshmërisë me Ligjin për RTK-në dhe Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuele gjatë vitit 2014, RTK1 është gjetur në shkelje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me: mos dallimin e komunikimeve komerciale audio-vizuale me mjete

dëgjimore, pamore apo hapësinore nga programet tjera (neni 9.1 i Rregullores për Komunikime Komerciale audio-vizuele), identifikimin dhe kohëzgjatjen e teleshopingut (neni 10.2.3) si dhe transmetimin e spoteve politike para fillimit të fushatës zgjedhore (neni 22.2).

### **Televizionet nacionale: TV21 dhe KTV**

Monitorimet e TV 21 dhe KTV kanë dëshmuar se këto dy shërbime mediale audio-vizuele kanë vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuele, respektivisht me dispozitat që kanë të bëjnë me orarin e reklamimit dhe kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale (neni 10.1), identifikimin dhe kohëzgjatjen e teleshopingut (neni 10.2.3), si dhe transmetimin e spoteve dhe tubimeve zgjedhore para fillimit të fushatës zgjedhore (nenet 22.1 dhe 22.2).

### **Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të**

Sipas 47 monitorimeve të bëra televizioneve regjionale e lokale dhe ofruesve të shërbimeve programore (OSHP-ve) të përfshira në këtë projekt, në shkelje të kësaj Rregulloreje janë gjetur: Turbo channel, TV Syri, TV Klan Kosova, TV Zoom, TV Liria, TV Tema dhe Rrokum TV.

Shkeljet më të shpeshta ishin ato për tejkalim të kohës së paraparë të komunikimeve komerciale audio-vizuele brenda një ore transmetimi, të përcaktuar me nenin 10 pika 1, mos-identifikimin e teleshopingut, mos transmetimin e pandërprerë prej 15 minutave të teleshopingut sipas nenit 10 pika 2.3, mos-dallimin e komunikimeve komerciale dhe teleshopingut nga pjesët tjera programore me anë të mjeteve pamore, dëgjimore apo hapësinore, nenit 9 pika 1, si dhe ndërprerja e lajmeve ose programeve për fëmijë (më të shkurtra se 30 minuta) me komunikime komerciale audio-vizuele apo teleshoping, të përcaktuar me nenin 9, pika 5.

### **Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit**

Rregullorja për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta përcakton se të licencuarit duhet të sigurojnë marrëveshje të vlefshme për të drejtën e autorit, kopjet e të cilave duhet t'i ofrojnë brenda afatit të paraparë në kërkesë të KPM- së.

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, shërbimeve mediale audio-vizuele të monitoruara u janë kërkuar marrëveshjet valide për transmetimin e programeve të caktuara.

*Për shkak të mos ofrimit të marrëveshjeve për të drejtën e autorit për programet e transmetuara, në shkelje janë gjetur këto shërbime mediale audio-vizuele: RTK, KTV, TV Herc, TV Prizreni, TV Klan Kosova dhe TV Dukagjini.*

Vlerësimi i pajtueshmërisë me të drejtën e autorit është intensifikuar veçmas në periudhën e organizimit të ligave dhe ndeshjeve të tjera sportive gjatë vitit 2014.

### **Monitorimi i Pajtueshmërisë së Shërbimeve Mediale Audio-vizuele me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së**

Me qëllim të krijimit të një pasqyre më të saktë për pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me skemën programore, respektivisht me formatin e programit, DMA ka monitoruar televizionet nacionale, regjionale/lokale dhe OSHP-të.



Në kuadër të këtij projekti të monitorimit, janë shikuar, matur dhe analizuar formatet dhe strukturat programore të programit një javor, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga stafi monitorues. Gjetjet nga këto monitorime janë krahasuar me të dhënat në Pjesën 3 të Licencës, të cilën subjektet transmetuese e kanë paraqitur me rastin e aplikimit për licencë të KPM-së.

Përkundër disa ndryshimeve në formatin dhe strukturën e programit, në periudhën monitoruese, shumica e shërbimeve mediale audio-vizuale janë gjetur në pajtueshmëri me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së – Formati i Programit.

Kjo, pasi që ndryshimet e bëra të ndonjë kategorie apo tipit të programit në shumicën e rasteve nuk kanë tejkaluar *një të katërtën e ndonjë kategorie të Tipit të Programit ose të Burimit të Programit* siç përcakton neni 2.1 i Pjesës 3 të Licencës.

Përfundim këtu bëjnë televizionet: TV Tema, TV Iliria TV Festina dhe TV Iliria, të cilat përkundër faktit se në aplikacion kanë bashkangjitur skema programore me lajme, intervista, emisione edukative, të sportit e dokumentarë, kanë bërë ndryshime të theksueshme të formatit të programit duke shtuar dukshëm sasinë e programeve muzikore (më shumë se 25%) ose duke eliminuar një kategori të programit, siç janë edicionet e lajmeve.

### **Monitorimi i Zgjedhjeve të Përgjithshme 2014**

KPM është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet nga të licencuarit (shërbimet mediale audio-vizuale).

Në mënyrë që të vlerësojë pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuale me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje i cili përcakton dispozitat për Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës, ka bërë monitorimin e mbulimit të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2014 në Kosovë.

Në monitorim janë përfshirë 24 shërbime mediale audio-vizuale, nga të cilat 3 televizione nacionale, 17 televizione regjionale dhe lokale si dhe 4 ofrues të shërbimeve programore (OSHP).

Fokus i monitorimeve ishin edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe spotet politike në kohën e shikueshmërisë më të madhe, nga ora 16:00 deri 24:00.

Gjatë monitorimit janë bërë matjet e hapësirës së dedikuar secilit subjekt politik të certifikuar, ndërsa, mënyra e prezantimit është vlerësuar si: pozitive, negative apo neutrale.

Gjetjet nga monitorimi i performancës së mediave gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2014, janë përmbledhur në raportin e dhënë në *shtojcën II (Monitorimi i Shërbyesve Medial Audio-Vizuel gjatë Fushatës për Zgjedhje Parlamentare – 2014.)*

### **Pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale**

Pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale është vlerësuar kryesisht me rastin e ankesave nga publiku ose rasteve *ex officio* për shkelje të Kodit të sjelljes, të ngritura nga KPM.

Lidhur me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuele janë bërë 19 monitorime, 10 prej të cilave janë bërë pas ankesave të cilat pretendojnë për shkelje nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuele.

DMA ka bërë monitorime të detajuara dhe analiza lidhur me ankesat e pranuar për përmbajtje të caktuar programore si dhe ato të ngritura *ex officio* nga KPM. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij Departamenti pas shqyrtimit të ankesave dhe realizimit të projekteve të monitorimit ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera kanë vazhduar me procedurat e mëtutjeshme.

### **Monitorimi i Operatorëve Kabllorë**

Lidhur me vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren e KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive, DMA gjatë këtij viti ka realizuar 53 monitorime, të cilat në të shumtën e rasteve janë bërë me rastin e vizitave në selitë e operatorëve kabllor.

### **Vizitat/ Inspektimet**

Me qëllim të identifikimit të operatorëve kabllorë të cilët veprojnë ilegalisht, zyrtarë të DMA-së kanë bërë vizita e inspektime në tërë territorin e Kosovës. Gjatë vizitave, zyrtarë të DMA-së kanë identifikuar operatorë kabllor ilegal, të cilët janë udhëzuar të ndërpresin operimin ilegal dhe të aplikojnë për licencë të KPM.

## **DEPARTAMENTI I LICENCIMIT**

### **Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës**

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për shërbime mediale audiovizuele, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së. Kështu , gjatë vitit 2014 kanë operuar gjithsej 20 TV Stacione, 78 Radio Stacione, 34 Operatorë Kabllorë dhe 54 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit kabllor.

Nga 20 shërbimet mediale televizive me transmetim tokësor të licencuara nga KPM-ja, tre (3) i përkasin kategorisë me mbulim nacional, dhjetë (10) me mbulim regjional dhe shtatë (7) me mbulim lokal. Kategorizimi është i bazuar në vendndodhjen e transmetuesve dhe parametrave teknik.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në fund të vitit 2014 ka ndryshuar Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale (Rregullorja KKPM-2010/02). Ndryshimet e Rregullores në fjalë kanë rezultuar vetëm në përcaktimin e definicioneve rreth kategorive të të licencuarve; përcaktimin e afateve rreth pagesës së tarifës nga të licencuarit si dhe është vendosur që të mos aplikohet kamata për vonesa në pagesën e taksës për licencë. Ndërsa, niveli për përcaktimin e shumës së taksës për secilën kategori dhe lloj të licencës mbetet i pandryshuar nga rregullorja paraprake. Që nga data 30 dhjetor 2014, ka hyrë në fuqi Rregullorja për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për

Licencë (Rregullorja KPM-2014/03), përmes së cilës janë dhënë edhe definicionet e qarta të përcaktimit të kategorizimit të të licencuarve.

### **Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:**

*Të licencuara 20 TV stacione:*

- *TV stacion publik;*
- *13 TV stacione në gjuhën shqipe;*
- *5 TV stacione në gjuhën serbe;*
- *1 TV stacion në gjuhën turke.*

*Të licencuara 78 Radio stacione*

- *2 radio stacione publike;*
- *44 radio stacione në gjuhën shqipe;*
- *22 radio stacione në gjuhën serbe;*
- *3 radio stacione në gjuhën boshnjake;*
- *2 radio stacione në gjuhën turke;*
- *2 radio stacione në gjuhën gorane;*
- *1 radio stacion në gjuhën rome;*
- *2 radio stacione multietnike.*

### **Numri i Operatorëve Kabllorë të licencuar:**

*Të licencuar 34 operatorë kabllorë*

- *28 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë shqiptarë;*
- *2 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë goranë;*
- *4 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë serbë.*

### **Ofruesit e Shërbimeve Programore (OSHP)**

*Gjithsej janë të licencuar 54 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit kabllor.*

- *50 OSHP janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;*
- *1 OSHP është i licencuar të transmetojë program në gjuhën Serbe ( OSHP TV Centar)*
- *3 OSHP janë të licencuar që transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK Neës dhe RTK Art)*

### **Shqyrtimi i kërkesave**

Gjatë vitit 2014, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 23 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHP-së, kërkesa për licencë të operatorëve kabllorë, kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë, refuzim ndaj kërkesave si të pa bazuara apo të pa kompletuara si dhe kërkesa që kanë të bëjnë me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së KPM-së.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2014 janë marrë këto vendime për licencim:

- 4 vendime për licencimin e OSHP-ve;
- 2 vendime për licencimin e operatorëve kabllorë;
- 3 vendime për ndryshimin e emrit;
- 4 vendime për ndryshimin e pronësisë;
- 5 vendim për revokimin e licencës – OSHP;
- 1 vendime për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit.
- 4 vendime për refuzim të kërkesave si të pa bazuara apo të pa kompletuara.

Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2015, janë gjithsej 2 raste:

- 1 kërkesa për licencë të Operatorëve Kabllorë;
- 1 kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit;

## **DEPARTAMENTI LIGJOR**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014 ka shqyrtuar raste të ndryshme të shërbyesve medial audio-vizual për shkelje të dispozitave të Ligjit 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër shërbyesve medial audio-vizual.

Rastet e procedura në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit të KPM-së, Ligjit për Zgjedhjet dhe akteve nënligjore të KPM-së janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

### **Rastet për transmetim ilegal-Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, e Ligjit të KPM-së**

Gjatë vitit 2014, janë proceduar shtatë (7) raste për shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”*, dhe neni 30, paragrafi 5, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”*.

Rastet e proceduara për shkeljen të nenit 21, paragrafi 1, të Ligji të KPM-së, janë paraqitur në tabelën 1 të shtojcës V të këtij raporti dhe kanë të bëjnë me dy (2) subjekte transmetues dhe katër (4) operatorë kabllorë të cilët kanë operuar pa licencë të KPM-së. Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Urdhra këtyre subjekteve dhe operatorëve për ndërprerje të transmetimit ilegal. Rastet bartën për vitin 2015 për procedim të mëtutjeshëm.

Pas dërgimit të Urdhrit për ndërprerje të transmetimit ilegal, një (1) nga operatorët kabllorë ka ardhur në pajtueshmëri, pasi që ka aplikuar për licencë dhe është pajisur me licencë të KPM-së. Rasti është mbyllur.

## **Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KPM - 2013/03**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014, ka proceduar nëntë (9) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KPM-2013/03.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me Shkrim, gjashtë (6) nga këto subjektet transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM 2013/03 dhe se rastet janë mbyllur, ndërsa tri (3) prej tyre bartën për shqyrtim për vitin 2015.

## **Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014, ka proceduar tetë (8) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2013/01.

Pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje, Vërejtjes me Shkrim dhe Urdhrit, shtatë (7) nga këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01. Rastet janë mbyllur.

Ndërsa një (1) subjekt transmetues edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me Shkrim, ka vazhduar ëtë veproj në kundërshtim me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio - Vizuale KPM 2013/01, dhe si rast ligjor bartet për shqyrtim për vitin 2015.

## **Rastet për shkelje të Rregullores për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014, ka proceduar tetë (8) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen e nenit 4, paragrafi 1, dhe 2, “Detyrimet për të Drejtat e Autorit” të Rregullores për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02.

Pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje dhe Vërejtjeve me Shkrim, katër (4) nga këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe se rastet ligjore janë mbyllur. Ndërsa katër (4) subjekte tjera transmetues nuk kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren për të Drejtën e Autorit KPM 2013/02, dhe bartën për shqyrtim në vitin 2015.

## **Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014, ka proceduar gjashtëmbëdhjetë (16) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me shkrim katërmëdhjetë (14) subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste ligjore janë mbyllur. Ndërsa dy (2) subjekte tjera edhe pas Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim dhe Urdhërit, kanë dështuar të

veprojnë në pajtueshmëri me Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Rastet bartën për vitin 2015 për procedim të mëtutjeshëm.

Për njërin nga këto raste (subjekti transmetues TV Zoom) Komisioni i KPM-së ka marr Vendim sanksionues me pezullim të gjitha programeve për tre muaj për shkelje të nenit 6, paragrafi 1, Kushtet dhe Tremet e Përgjithshme të Licencës të KPM-së. Subjekti transmetues TV Zoom, pas marrjes së Vendimit të Komisionit të KPM-së ka ardhur në pajtueshmëri. Rasti është mbyllur.

### **Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM-2010/02**

*Mos pagesa e taksës për licencë, si dhe mos pagesa e kamatës së taksës për licencë.*

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014 ka proceduar tetëdhjetë (80) raste lidhur me këtë shkelje. Departamenti Ligjor për të gjitha këto raste ka dërguar Shkresë. Nga 80 subjekte, shtatëmbëdhjetë (17) prej tyre kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02 Ndërsa gjashtëdhjetë (63) prej tyre kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02. Këto raste bartën për shqyrtim në vitin 2015.

### **Rastet e Shkeljes së Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale KKPM- 2010/01**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014 ka proceduar pesë (5) raste lidhur me këtë shkelje:

- Të gjitha subjektet transmetuese, pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjeve nga ana e Departamentit Ligjor kanë ardhur në pajtueshmëri me Kodin e Sjelljes KKPM-2010/01, dhe si raste ligjore janë mbyllur.

### **Rastet për shkeljen e Rregullores për Distribuim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014 ka proceduar tridhjetë (30) raste lidhur me këtë shkelje:

- Pas dërgimit të Vërejtjeve nga ana e Departamentit Ligjor për shkelje të nenit 18, paragrafi 4, trembëdhjetë (13) Operator Kabllor , kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.
- Ndërsa shtatëmbëdhjetë (17) operatorëve tjerë i janë dërguar shkresa për shkelje të nenit 11, paragrafi 2 dhe nenit 2.1.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe pas dërgimit të Shkresave, kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.

### **Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së neni 28-Mos sjellja e raportit vjetor**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014, ka proceduar tridhjetekatër (34) raste lidhur me këtë shkelje:

Pas dërgimit të Vërejtjeve me shkrim nga ana e Departamentit Ligjor, këto tridhjetekatër (34) subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

## **Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së, Neni 22, paragrafi 3.1 (përfshirja e pronarëve të medieve në aktivitete politike)**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014, ka proceduar dy (2) raste lidhur me këtë shkelje: Subjektet transmetuese Radio Kosovska Mitorvica dhe Radio Premiera, kanë bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1. Departamenti Ligjor iu ka dërguar Urdhër me shkrim, edhe pas dërgimit të Urdhrit me shkrim subjekte kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. Komisioni i KPM-së mori Vendim sanksionues për ndërprerje të licencës së transmetimit. Rastet janë mbyllur.

## **Rastet e Shkeljes së Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme kreut VIII, Nr. 03/L-073, Neni 49, paragrafi 6**

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2014 ka proceduar tetëdhjetenëntë (89) raste lidhur me këtë shkelje:

Nga këto tetëdhjetenëntë (89) raste katër (4) prej tyre kanë bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, ndërsa dhjetë (10) prej tyre kanë bërë shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të cilat pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me shkrim nga ana e Departamenti Ligjor, kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

Ndërsa në shkelje të nenit 49, paragrafi 7, janë gjetur shtatëdhjetepesë (75) subjekte tjera të cilat pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me shkrim, kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

## **Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2014**

Janë proceduar katër (4) raste:

- Rasti i parë është proceduar bazuar në ankesën e OSHP Business Channel 1 për tërheqje të propozimit për përmbarim të paraqitur në Gjykatën Themelore departamenti për Çështje ekonomike, për shkak të dështimit të pagesës së taksës për licencë për vitin 2010 nga ana e OSHP Business Channel 1 me pretendimin se nuk është i obliguar ta beje pagesën e taksës për licencë për vitin 2010. KPM ka bërë shqyrtimin e ankesë së parashtruar nga ana e OSHP Business Channel 1, dhe i ka dërguar Shkresë me shkrim, duke i shpjeguar së në bazë të Propozimit për Përmbarim është i obliguar që të paguaj taksën edhe për vitin 2010, ashtu siç ka vepruar edhe për vitet paraprake.
- Rasti dytë, është proceduar bazuar në ankesën e Asociacioni i Arkitekteve të Kosovës të parashtruar kundër OSHP Klan Kosova për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audiovizuale KKPM-2010/01, ankesa i referohet emisionit “ Zona B” të transmetuar në Klan Kosova ndaj një kronike të cilën pala ankuese e cilëson si tendencioze ndaj Asociacionit të arkitekteve të Kosovës dhe anëtarësisë së saj. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e Klan Kosova, dhe ka gjetur se Klan Kosova nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio vizuale KKPM-2010/01. Pas analizimit dhe verifikimit të fakteve KPM ka konstatuar se ankesa ndaj Klan Kosova ka qene e pabazuar. KPM i është përgjigjur përmes postes elektronike Asociacionit të Arkitekteve të Kosovës për sqarim se ankesa e tyre ka qenë e pa bazuar. Rasti është mbyllur.

- Rasti i tretë është proceduar bazuar në ankesën e subjektit politikë Vetëvendosje dega Drenas ndaj OSHP Star TV, ku në ankesë thuhet se Star TV, ka bërë shkelje të nenit 1.3, 4.1 dhe 1.4 të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audiovizuale KKPM- 2010/01, gjatë transmetimit të mbledhjes të Kuvendit Komunal të Drenasit, duke shkurtuar transmetimin e mbledhjes në momenti kur është paraqitur asamblisti i subjektit politik Vetëvendosje. KPM ka bërë shqyrtimin e ankesës së subjektit politik Vetëvendosje dhe ka bërë monitorimin e Star TV. KPM gjatë monitorimit ka vërejtur se Star TV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audiovizuale KKPM 2010/01. Departamenti Ligjor i ka dërguar Shkresë subjektit politik Vetëvendosje për sqarim se ankesa ka qenë e pa bazuar. Rasti është mbyllur.
- Rasti i katërt është proceduar bazuar në ankesën e subjektit transmetues TV Center ndaj TV PULS, ku në ankesë thuhet se TV Puls ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audiovizuale KKPM-2010/01. KPM ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe ka bërë monitorimin e TV Puls. KPM gjatë monitorimit ka vërejtur se TV Puls nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audiovizuale KKPM 2010/01. Departamenti Ligjor i është përgjigjur përmes postes elektronike TV Center për sqarim se ankesa e tyre ka qenë e parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjorë dhe ka qenë e pa bazuar. Rasti është mbyllur.

## **DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR**

### **Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge**

Gjatë vitit 2014, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2011, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

### **Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)**

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (65 dBuV/m për TV dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizim të rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.



Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m ) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjeti sekondar, ashtu që të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

### **Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)**

Gjatë vitit 2014, Departamentit për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2014, të cilat kanë patur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 Mhz).

DMF-ja gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njëjtë si dhe gjatë vitit paraprak që tregojnë se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa, niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dbuv/m. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivove, Llabjan, Parlllovë dhe Bresalc); Kacanik – Hani i Elezit; Mitrovicë – Bajgorë; Shtime – Carralevë, Dragash – Restelicë; Prizren – Brezovicë; Kramovik – Dollc; Pejë Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka fare pranim të sinjalit të radiove nacionale. Në bazë të këtyre rezultateve, KPM konstaton se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk janë duke transmetuar në pajtim me parametrat teknikë siç janë të përcaktuara me pjesën 2 të licencës së KPM-së.

Me gjithë rekomandimin e bërë nga ana e KPM-së, radiove nacionale, që të transmetojnë në pajtim të plotë me parametrat teknikë të përcaktuara në pjesën 2 të licencës së KPM-së me qëllim të ngritjes së cilësisë së sinjalit të transmetimit si dhe shërbimin më cilësor në zonat e përcaktuara me licencë të KPM-së, radiot nacionale nuk janë përgjigjur fare, lidhur me veprimet që kanë ndërmarrë.

KPM është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa, në bashkëpunim me ta edhe të gjej lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

### **Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal**

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth 68.14% të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth 96.98% të territorit të Kosovës.

### **Rastet për interferencë**

Gjatë vitit 2014 DMF, ka pranuar vetëm një ankesë për interferencë nga subjekti transmetues radio Omega 3 në komunë të Prizrenit. Raporti i monitorimit lidhur me këtë ankesë rezulton se nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues.

### **Subjektet transmetuese që kanë ndërperë transmetimin**

Gjatë vitit 2014, DMF gjatë matjeve të bëra konstaton se Radio Mix ( Prilluzhje/Obiliq) me frekuencë 97.2 MHz, Top Radio (Gjakovë) me frekuencë 103.3 MHz dhe TV Zoom ( Gonje Kusce/Gjilan) në kanalin CH43, nuk janë duke transmetuar.

### **Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR.**

DMF gjatë vitit 2014 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja. Gjatë vitit 2014, radiot e huaja ndërkombëtare BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre. Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare , nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës. Vazhdon bashkëpunimi i KPM-së me KFOR për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it.

### **Gjetja e frekuencave të lira**

Gjatë vitit 2014 sikurse edhe në vitin paraprak, DMF ka bërë matje dhe analiza për frekuencat të lira në nivel të mbulimit lokal në ato lokacione, ku KPM-ja ka paraparë si të nevojshëm ndonjë subjekt të ri transmetues. Frekuencat të lira për radio lokale janë paraparë në: *Lipjan, Junik, Hani i Elezit, Mamushë dhe Graçanicë, Obiliq dhe Istog ( fshati Osojan, me fuqi të ultë)*, të cilat janë në pajtim me Planin Frekuencor të Kosovës në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 -108 MHz).

### **Kërkesa për ndryshimin të lokacionit të transmetimit**

Gjatë vitit 2014 DMF ka proceduar me këto kërkesa të subjekteve transmetuese të licencuara për ndërrim të lokacionit të transmetimit:

TV Liria- kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit (brenda qytetit të Ferizajt);

Radio Drenasi/Drenas - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit nga qyteti i Drenasit në pikën e transmetimit në male të Berishës..

Top Radio/Gjakovë - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit nga Gjakova në pikën e transmetimit në Zatriq.

Kërkesat e Radio Drenasit dhe TV Liria janë zgjidhur pozitivisht, ndërsa Top Radio/Gjakovë i është refuzuar vendosja e transmetuesit në Zatriq (pikë për transmetim nacional) dhe është rekomanduar të propozon ndonjë lokacion tjetër ose Zymin ku janë të vendosura disa subjekte transmetuese tjera të rajonit të Dukagjinit.

### **Ndryshimet e frekuencave (kanaleve TV) të subjekteve transmetuese:**

Gjatë vitit 2014 DMF ka proceduar me katër raste për ndryshim të kanaleve të transmetimit televiziv. Tri raste kanë të bëjnë me Televizionet nacionale RTK, KTV dhe RTV21 dhe i katërti me TV Herc/Shtërpce.

Televizionet nacionale RTK, KTV dhe RTV21 kanë bërë ndërrime të tri (3) kanaleve televizive Ch7, Ch44 dhe Ch48, kanale të cilat janë përdorur për transmetim në pikën për transmetim nacional Cërnushë/Mitrovicë, duke i zëvendësuar me kanalet Ch10, Ch28 dhe Ch35, kanale të koordinuara sipas Planit të ITU-së për transmetim për pikën e Cërnushës. Ky ndryshim i kanaleve është bërë në harmoni me Planin Frekuencor Televiziv të Kosovës.

Me aktivizimin e këtyre kanaleve, është paraqitur interferenca në kanalën ch 35, ku në transmetim në këtë kanal është edhe TV Herc nga pika Piribreg/Shtërpçë. Pasi që kanali Ch35 është i koordinuar të transmetoj nga Cërnusha, TV Herc-it i është propozuar që të ndryshojë kanalën e transmetimit në Ch26 dhe se këtë propozim e ka pranuar dhe TV Herc vazhdon të transmeton në kanalën televiziv Ch 26 nga Piribregu/Shtërpçë.

### **Ngritja e kapaciteteve**

Gjatë vitit 2014, DMF ka ndjekur një pjesë të trajnimit në Francë për punën me softëerin ICS Telekom/ATDI për planifikim frekuencor digjital, në kuadër të fillimit të Implementimit të Projektit “Sistemi digjital” - projekt kapital i financuar nga Buxheti i Kosovës, me qëllim për avcimin e paisjeve softëerike dhe hardverike të KPM-së për planifikim dhe implementim të sistemit digjital në Kosovë. Me realizimin e tërsishëm të këtij projekti, do të mundsohet të bëhen përgaditjet e duhura rreth procesit të zhvillimit të dialogut për zbatimin e marrëveshjes me Serbinë (për Telekomin në kuadër të së cilës hyn edhe koordinimi i frekuencave digjitale), me qëllim që të mos ketë interferime në brezin frekuencor nga të dy palet në brezet radio difuzive UHF/VHF/TV, bandet III, IV dhe V.

## DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

### Buxheti

Komisioni i Pavarur i Mediave është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Për vitin 2014, KPM-së i është ndarë buxhet prej 1,415,174 Euro duke përfshirë investimet kapitale prej 694,000 Euro.

Për periudhën Janar dhjetor 2014, Komisioni i Pavarur i Mediave ka shpenzuar buxhetin në vlerë prej 1,370,440 euro apo 97 %.

Buxheti i Komisionit të Pavarur i Mediave për vitin 2014				
Kategoritë	Buxheti	Buxheti	Buxheti i	Buxheti i
	Fillestar	Final	shpenzuar	pashpenzuar
Pagat dhe mëditjet	373,769	367,769	331,777	35,992
Mallra dhe Shërbime	395,770	336,405	335,977	428
Shërbime Komunale	20,000	17,000	17,000	0.00
Gjithsejt Projekt.Kapit.	694,000	694,000	685,686	8,314
Sistemi Digjital	400,000	400,000	392,045	7,955
Arkiva Elektronike	294,000	294,000	293,642	359
<b>Total:</b>	<b>1,483,539</b>	<b>1,415,174</b>	<b>1,370,440</b>	<b>44,734</b>

Nga të hyrat vetanake të mbledhura prej taksës së licencës nga shërbimet audio-vizuale janë gjeneruar 325,162 Euro, prej tyre 291,330 euro u takojnë të hyrave nga licenca ndërsa shumat prej 23,333 euro dhe 10,498 euro u takojnë kamatave për vonesa dhe gjokat. Mjetet nga të hyrat shkujnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve buxheti fillestar në vlerë prej 373,769 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar 367,769 euro. Ky zvogëlim në vlerë prej 6,000 euro është bërë me deklarinimin e kursimit në paga dhe mëditje me kërkesë të Departamentit të Thesarit me numër të protokollit 275 të datës 12.09.2014.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti fillestar në vlerë prej 395,770 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 336,405 euro si rezultat i zbatimit të Vendimit nr. 07/172 të datës 27 Shkurt 2014, aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kemi shkurtime buxhetore 15% në kategorinë e Mallrave & Shërbimeve.

Po ashtu, edhe në kategorinë e komunalive buxheti fillestar në vlerë prej 20,000 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 17,000 euro si rezultat i zbatimit të Vendimit nr. 07/172 kemi 15% shkurtime buxhetore.

Në kategorinë e Projekteve Kapitale janë aprovuar Projektet në vazhdim me titull: 1) Sistemi Digjital me vlerë prej 400,000 euro dhe 2) Arkiva Elektronike me vlerë prej 294,000 euro. Vlera totale e shpenzuar në kategorinë e Projekteve Kapitale është 685,686 euro apo 99 % (Shtojca IV a dhe IV b Raporti Financiar).

## **PUNA E BORDIT PËR ANKESA (BA)**

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit të KPM-së. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së.

### **Seancat e BA dhe Vendimet**

Bordi për Ankesa (BA) gjatë vitit 2014, ka shqyrtuar gjithsej katër (4) ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së.

Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e Bordit për Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së gjatë vitit 2014 janë si në vijim:

1. Ankesa e subjektit transmetues Radio Klokot. Bordi për Ankesa, me datën 12 shkurt 2014, ka shqyrtuar ankesën e Radio Klokot kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 1,000. (njëmijë) euro, për shkelje të nenit 28 mos sjellja e raportit vjetor financiar, të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44. Pas shqyrtimit të ankesës së Radio Klokot, Bordi për Ankesa e hodhi poshtë ankesën si të pa afatshme.
2. Ankesa e subjektit transmetues Radio Hit Laser. Bordi për Ankesa me datën 4 mars 2014, ka shqyrtuar ankesën e subjektit transmetues Radio Hit Laser kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 1.000 (njëmijë) euro, për shkelje të nenit 28, Kërkesat për raportim, të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44. Pas shqyrtimit të ankesës së subjektit transmetues Radio Hit Laser, Bordi për Ankesa e vërtetoi vendimin sanksionues të shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.
3. Ankesa e subjektit transmetues RTK 1. Bordi për Ankesa me datën 3 prill 2014, ka shqyrtuar ankesën e subjektit transmetues publik kundër Vërejtjes së Zyrës Ekzekutive të dërguar nga Departamenti Ligjor, për shkelje të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01. Pas shqyrtimit të Ankesës Bordi për Ankesa ka hedhur poshtë ankesën e parashtuar kundër Vërejtjes së Zyrës Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media. Bordi për Ankesa në bazë të nenit 36, paragrafi 2 të ligjit të KPM-së, shqyrton vetëm ankesat e palëve ndaj Vendimeve të cila i merr Komisioni i KPM-së.
4. Ankesa e subjektit transmetues TV Zoom. Bordi për Ankesa me datën 12 nëntor 2014, ka shqyrtuar ankesën e TV Zoom kundër Vendim të Komisionit të KPM-së, për shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Bordi për Ankesa pas shqyrtimit të Ankesës së TV Zoom, ka konstatuar se ankesa e palës ankuese është e pa bazuar dhe si e tillë refuzohet, dhe ka vërtetuar Vendimin e Komisionit të KPM-së.

## **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014**

Në vitin 2014 ka vazhduar realizimi i objektivave nga viti 2013:

### **– Finalizimi i strategjisë për digjitalizim**

Draft Strategjia e përgatitur dhe konsultimi publik është iniciuar në dhjetor 2014. Në kuadër të investimeve kapitale janë bërë edhe zhvillim i kapacitete të brendshme.

### **– Zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben gjithë qytetarëve të Kosovës**

Është bërë analiza e nevojave sipas mbulueshmërisë me radio sinjal dhe sipas kërkesave të prezantuara në KPM. Me qëllim që të sigurohet informim edhe në disa komuna të reja dhe në disa vende me specifika të caktuar është vendosur për licencime të reja dhe më 26 dhjetor 2014 është shpallur konkursi publik për 8 frekuenca të reja për radio në 8 komuna të Republikës së Kosovës.

### **– Avansimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane**

Në frymën e bashkëpunimit është bërë nënshkrimi i marrëveshjes me rregullatorin e Turqisë si dhe është realizuar vizitë punë dhe studimore tek rregullatori i Francës.

### **– Finalizimi i të gjitha procedurave për ndryshimin e akteve nënligjore për transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audio dhe audio-vizuale në operatorët e rrjeteve (ndryshimi i rregullores për operatorët kabllorë), dhe rregullorja për nivelin dhe pagesën e taksës për licencë.**

Është bërë amandamentimi i rregullores për nivelin dhe pagesën e taksës për licencë. Janë ndjekur procedurat e konsultimit publik dhe rregullorja e re KPM 2014/03 është miratuar nga Komisioni në dhjetor 2014.

Komisioni ka krijuar grupin e brendshëm dhe ka ndryshuar edhe rregulloren për operatorët kabllorë ndërsa procedurat e konsultimit publik dhe të miratimit do të përcillen në pjesën e parë të vitit 2015.

## **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2015**

Për vitin 2015, prioritet parësor i KPM-së është:

- Implementimi i Strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës
- Krijimi i bazës ligjore sekondare për zbatueshmërinë e Strategjisë
- Ndërtimi i rrjetit për transmetim televiziv tokësor digjital SFN- allotmenti Kosova

## **Rekomandimet/sfidat e institucionit (problemet me buxhetin, rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)**

### Problemet me buxhetin

Shkurtime të buxhetore që KPM ka pasur në këto dy vitet e fundit, na bëjnë që të jemi të kufizuar në funksionimin tonë si një institucion i pavarur dhe rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme.

### Nevoja për punëtorë të rinj

Për disa vjet radhazi, KPM kërkon shtimin e stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërlihen me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM është rritur dukshëm dhe se shtimi i volumit të detyrave për nëpunësit ekzistues është trefishuar. KPM-ja ka paraqit kërkesa në vazhdimësi dhe ende nuk është aprovuar kjo rritje e numrit të punëtorëve. Aktualisht jemi duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë për të kryer detyrat sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësojë edhe punën e KPM-së në procesin e periudhës tranzitore dhe pastaj implementimit të Strategjisë së Digjitalizimit.

### Miratimi i Draft Strategjisë dhe Ligjit për Digjitalizim

KPM në bazë të nenit 3 paragrafi 1.1, KPM është përgjegjëse për përgatitjen e Strategjisë për Digjitalizim. KPM deri më tani në bashkëpunim me institucionet relevante përmes grupeve të ndryshme punës ka përgatitur draft strategjinë për digjitalizim në pajtim me nenin 3.1.1 të Ligjit të KPM-së. Ndërsa në bazë të nenit 47 të Ligjit të KPM-së, parashihet se Procesi i kalimit në transmetimin digjital do të rregullohet me ligj të veçantë. Prandaj, kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës që mos ta procedojë ligjin për digjitalizim, para miratimit të strategjisë për digjitalizim, pasi që këto dy dokumente duhet të jenë në harmoni me njëra tjetrën, dhe se ligji për digjitalizimin duhet të rrjedh nga strategjia për digjitalizim.

KPM, propozon që paralelisht me ligjin për digjitalizim të bëhet amendamenti i Ligjit të KPM-së dhe të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP-it), me qëllim që të shmangët koluzionin i krijuar në mes të këtyre dy ligjeve, pasi që përzirja e kompetencave me këto dy ligje përpos që është shkelje e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, reflekton edhe në vet Ligjin për digjitalizim.

### Kolezioni në mes të Ligjit të KPM-së dhe ARKEP-it

KPM propozon formimin sa më të shpejt të grupeve punuese për amendamentimin e ligjit për KPM-në dhe Ligjin për Komunikime Elektronike, që të shmangët shkelja e nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të mos ketë koluzion në kompetencat në mes KPM-së dhe ARKEP-it.

Me Ligjin e KPM-së 04/L-44 (nenin 3 paragrafi 1) kompetencat për menaxhim dhe shfrytëzim të spektrit të transmetimeve për radio dhe TV, i janë dhënë KPM-së. Në Projektligjin për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, i cili është përcjellur në Qeveri për

shqyrtim dhe aprovim, ka përbajtje të neneve që paraqesin ndërhyrje të ARKEP –it në kompetencat e KPM-së, pra pikërisht në fushën e menaxhimit dhe rregullimit të brezit frekuencor radiodifuziv ku aktualisht kjo kompetence i takon KPM-së.

Shembull i neneve ku paraqiten ndërhyrje të drejtpërdrejte:

Me me nenin 23 të projektligjit për digjitalizim është paraparë që KPM të bëjë mbikëqyrjen e këtij sa i përket përbajtjes ndërkaq cilësia e shërbimeve të mbikëqyret nga Autoriteti (ARKEP).

Me nenin 4 alineja 4 të projektligjit për digjitalizim është paraparë që ( Plani për Shfrytëzimin e Radio-Frekuencave (kanaleve) do të përgatitet nga KPM dhe Autoriteti, në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Ligjin për Komunikimet Elektronike.

## **Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)**

Veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak janë paraqitur si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Rekomandimi ose gjetja</b>	<b>Veprimi i ndërmarrë ose propozuar</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Efekti</b>
<b>1.</b>	<b>Rekomandimi 1</b> Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se proceset e filluara rreth ndryshim/plotësim rregullores ekzistuese të përfundohen, duke e bërë këtë rregullore më të lehtë në zbatim.	KPM-ja ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe tani është në proces të plotësimit të Rregullores së KPM-së për mënyrën e pagesës së taksës së licencës.	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv
<b>2.</b>	<b>Rekomandimi 2</b> Kryetari i Komisionit duhet të siguroj kontrole funksionale gjatë procesit të ekzekutimit të pagesave. Të gjitha format e kërkuara me rregulla të thesarit, duhet të plotësohen në mënyrë të qartë dhe kronologjike.	KPM do të kujdeset për procesimin e të gjitha pagesave duke respektuar rregullat e thesarit.	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv
<b>3.</b>	<b>Rekomandimi 3</b> Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se ka harmonizuar numrin e të punësuarve në listën e pagave me numrin e stafit të lejuar me ligjin e	KPM do të kujdeset për të siguruar se në listën e pagave të figurojnë ndaras lista e stafit me 31 pozita dhe lista e Komisionit dhe Bordit që	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv



	ndarjeve buxhetore.	janë të aprovuar 10 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.		
--	---------------------	--	--	--

Shënim: KPM ka pranuar rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit për vitin 2013, duke i cilësuar si të dobishme për përmirësimin e menaxhimit të aktiviteteve të saj dhe cilësisë së raportimit dhe KPM ka ndërmarr masat e nevojshme që të implementohen.

#